

SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË

KODI

ETIKA PROFESIONALE

Funksioni propozues	Këshilli Drejtues
Funksioni aprovues	Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve
Data e aprovimit	24.10.2020

Përmbajtja

Parathënie	2
Hyrje	3
Përkufizime	5
Kapitulli I Kërkesa të Përgjithshme të Kodit	7
100. Parimet Themelore.....	8
110. Integriteti.....	11
120. Objektiviteti	12
130. Kompetenca Profesionale dhe Vigjilenca e Duhur.....	12
140. Mbrojtja e konfidencialitetit	13
150. Sjellja profesionale.....	14
Kapitulli II. Kontabilistët e Miratuar dhe Shoqëritë e Kontabilitetit	16
200. Hyrje	17
210. Emërimi profesional.....	20
220. Konfliktet e interesit	23
230. Mosrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve	26
240. Tarifat dhe shpërblimet.....	29
250. Marketimi i shërbimeve profesionale	30
260. Dhuratat dhe trajtimet preferenciale	30
270. Marrja në ruajtje e aseteve të klientit.....	31
280. Objektiviteti – Të gjitha shërbimet	32

Parathënie

Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë është e para organizatë profesionale e Kontabilistëve të Miratuar, themeluar në Republikën e Shqipërisë dhe gëzon respekt të gjerë në opinionin publik. Shoqata kërkon ndaj anëtarëve të saj qasje profesionale dhe etike, në mënyrë të tillë që reputacioni që ajo gëzon të mos cenohet. Janë pikërisht standardet e larta, trajnimet cilësore si dhe profesionalizmi i anëtarëve të Shoqatës, që ndikojnë në reputacionin dhe emrin e mirë që ajo gëzon. Për të ndihmuar anëtarët e saj në ruajtjen e këtyre standardeve, si dhe dhënien e shërbimeve me profesionalitet të lartë, Shoqata publikon *Kodin e Etikës Profesionale*, drejtuar anëtarësisë së saj, në të cilin përfshihen parimet themelore si dhe udhëzimet Mbështetëse.

Vendimet e marra nga secili anëtar i Shoqatës gjatë veprimtarisë së tij profesionale mund të kenë pasoja nga këndvështrimi i sjelljes etike dhe është pikërisht kjo arsye që ky Kod duhet të shërbejë si udhërrëfyes për anëtarësinë e Shoqatës.

Kodi:

- Përcakton dhe udhëzon mbi standardet e kërkuara për të pasur qasje profesionale.
- Udhëzon mbi mbrojtjen e interesit publik.
- Ndihmon në ruajtjen e reputacionit të mirë që gëzon Profesionit dhe Shoqata.

Hyrje

Kodi i Etikës së Kontabilistëve të Miratuar bazohet në *Code of Ethics for Professional Accountants*, i miratuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (IESBA), i cili ka hyrë në fuqi më datë 1 janar 2011. Rishikimet e ndryshme që i janë bërë këtij Kodi ndër vite janë asimiluar edhe në Kodin e Etikës së SH.K.F.SH.-së. Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë, me shprehjen e interesit për t'u anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC) në shtator 2019, po përqendron energjitë e saj në harmonizimin e dokumentacionit të saj me praktikat më të mira ndërkombëtare. Misioni i IFAC, si parashikuar dhe në statutin e saj, është “zhvillimi dhe përmirësimi i harmonizuar i Profesionit të Kontabilistit në mbarë globin, të aftë për të dhënë shërbime cilësore në interes të publikut”.

Në arritjen e këtij qëllimi, Bordi i IFAC ka themeluar IESBA dhe e ka ngarkuar me detyrën për të zhvilluar dhe publikuar, nën autoritetin e saj, standarde të larta etike si dhe udhëzime të adresuara për përdorim nga anëtarët e saj. Kodi i Etikës i publikuar nga IESBA, mbi të cilin bazohet Kodi i SH.K.F.SH., përcakton kërkesat etike për të gjithë anëtarët e IFAC.

Për t'iu përmbajtur parashikimeve të Kodit të IFAC, Kodi i SH.K.F.SH.-së ka një qasje të bazuar mbi parime të përgjithshme, pasi do të ishte e pamundur të mbulohen në këtë Kod të gjitha problematikat e mundshme etike, si dhe përgjigjja ndaj tyre. Përkundrazi, Kodi adopton një sistem vlerash, duke u përqendruar në parimet themelore profesionale dhe etike, të cilat përbëjnë

bërthamën e sjelljes profesionale, të cilat çdo anëtar i Shoqatës duhet t'i ndjekë me përpikërinë maksimale.

Për këtë arsye, ky Kod:

- Përcakton 5 parimet themelore, të cilat duhet të ndiqen nga të gjithë anëtarët:
 - Integriteti
 - Objektiviteti
 - Kompetenca Profesionale dhe Vigjilenca e Duhur
 - Mbrojtja e konfidencialitetit
 - Sjellja profesionale
- siguron kuadrin konceptual, të cilin anëtarët duhet ta zbatojnë për t'u mundësuar atyre identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve ndaj pajtueshmërisë me parimet themelore, si dhe marrjen e masave mbrojtëse të duhura;
- siguron udhëzime dhe sjell shembuj mbi mënyrën se si duhet të zbatohet kuadri konceptual në përgjithësi si dhe në situata specifike. Anëtarët duhet t'i konsiderojnë udhëzimet dhe shembujt e ndryshëm në mënyrë që pajtueshmëria me parimet themelore të mos cenohet nga situatat e ndryshme, me të cilat ata ndeshen gjatë ushtrimit të profesionit.

Kodi është i ndarë në 2 kapituj:

- Kapitulli i parë i drejtohet dhe duhet të zbatohet nga të gjithë anëtarët e Shoqatës.
- Kapitulli i dytë parashikon udhëzime shtesë dhe u adresohet në veçanti Kontabilistëve të Miratuar Aktivë, qofshin ata të organizuar në trajtën e Shoqërive të Kontabilitetit.

Përdorimi përgjatë gjithë Kodit i 3 fjalëve kyçe shërben për udhëzimin e anëtarëve në veprimet që duhet të ndërmarrin për respektimin e parimeve themelore:

- Fjala “Konsidero” përdoret kur anëtarëve u kërkohet të gjykojnë mbi çështje të caktuara.
- Fjala “Vlerëso” përdoret kur anëtarëve u kërkohet të gjykojnë mbi çështje të caktuara dhe të vlerësojnë faktorët pozitivë dhe negativë.
- Fjala “Përcakto” përdoret kur anëtarëve u kërkohet të marrin vendime mbi bazën e konkluzioneve të arritura.

Ky Kod është i bazuar mbi ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Shqipërisë, respektimi i të cilave është detyrim ligjor. Anëtarët, të cilët jetojnë dhe punojnë jashtë Republikës së Shqipërisë, duhet të marrin dijeni mbi parashikimet ligjore të vendit pritës.

Gjatë shfletimit të këtij Kodi mund të hasen implikime ligjore të ndryshme për çështje të caktuara, këshillimi ligjor dhe trajtimi i të cilave nuk mund të parashikohet specifikisht në përmbajtjen e këtij dokumenti. Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë rekomandon të gjithë

anëtarët, të cilët ndeshen me problematika ligjore gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, të kërkojnë këshillimin ligjor të nevojshëm nga ekspertë të fushës.

Në rastin kur anëtarët, pavarësisht këshillimit të duhur ligjor, kanë dyshime mbi zbatueshmërinë e Kodit, mund të kërkojnë dhe adresojnë kërkesën e tyre për ndihmë ndaj Shoqatës në rrugë elektronike në adresën: info@shkfsh.org ose në rrugë postare në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Pallati 172, Ap.5, Tiranë.

Anëtarët duhet të jenë në dijeni se shkelja ndaj sjelljes së duhur profesionale dhe personale, në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale, përkufizohet si ajo sjellje, e cila vë në rrezik interesin publik apo edhe dëmton reputacionin e Shoqatës dhe anëtarëve të saj. Kërkoheq që anëtarët të marrin dijeni për kërkesat e këtij Kodi.

Anëtarët duhet të jenë në dijeni se në rastet kur janë njëkohësisht dhe anëtarë të një organizate tjetër profesionale të njohur nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, të cilat mund të kenë kërkesa të ndryshme etike dhe profesionale, atëherë anëtarit i kërkoheq të ndjekë dispozitat më të rrepta ndërmjet organizatave profesionale ku ai është anëtar.

Profesioni i Kontabilistit, përfshirë sa parashikohet për anëtarët e SH.K.F.SH.-së, angazhohet kundrejt objektivave të mëposhtëm:

- Përvetësimi i njohurive teknike dhe specifike, të cilat mund të asimilohen përmes edukimit të vijueshëm profesionale dhe procesit individual të studimit dhe ushtrimit të profesionit.
- Zhvillimi i një qasjeje etike kundrejt klientëve dhe punëdhënësve, e cila fitohet përgjatë eksperiencave profesionale dhe trajnimeve si dhe forcohen nga kërkesat e rrepta etike dhe profesionale të parashikuara nga Rregulloret e ndryshme të Shoqatës.
- Marrjen dijeni të detyrimeve karshi interesit publik në përgjithësi dhe klientit/punëdhënësit në veçanti.
- Qasje objektive ndaj problematikave, e cila përfitohet nga të gjykuarit në mënyrë të drejtë dhe të mos pasurit konflikt interesi.
- Kryerjen e shërbimeve profesionale me standarde të larta profesionale dhe qasje të drejtë.
- Arritjen e perceptimit nga publiku se anëtarët ofrojnë shërbime profesionale, që u përmbahen kërkesave dhe standardeve të larta.

Përkufizime

Në Kodin e Etikës për Kontabilistët e Miratuar anëtarë të Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Anëtar” është individi ose shoqëria e kontabilitetit, e anëtarësuar në Shoqatë në përputhje me parashikimet në Statut dhe/ose rregulloret e Shoqatës, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.
- b) “Kontabilist i Miratuar” është personi fizik, i regjistruar në regjistrin publik të një organizate profesionale të kontabilistëve të miratuar dhe të njohur nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, që përmbush kushtet e nenit 49 të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.09, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i cili mban statusin Aktiv ose Jo-aktiv sipas përcaktimeve ligjore dhe vepron në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, me këtë Statut dhe Kodin e Etikës së Shoqatës së Kontabilistëve dhe të Financierëve të Shqipërisë (SH.K.F.SH).
- c) “Shoqëri kontabiliteti” janë shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime kontabiliteti.
- d) “Bordi i Mbikëqyrjes Publike” është organi publik i mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, i cili, gjithashtu, ka kompetenca edhe për mbikëqyrjen e organizmave profesionalë të kontabilistëve të miratuar.
- e) “Kualifikim i vijueshëm profesional” është procesi i edukimit të detyrueshëm që çdo Kontabilist i Miratuar duhet të kryejë çdo vit në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.09, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar.
- f) “Kursët e Kualifikimit” janë kursët e zhvilluara në fushën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, të raportimit financiar apo të fushave të tjera të lidhura me to, si dhe kursët e tjera profesionale që realizon Shoqata për kandidatët që kërkojnë të fitojnë titullin “Kontabilist i Miratuar”, apo për anëtarësinë e saj.
- g) “Ligji për parandalimin e pastrimit të parave” është Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar me Ligjin Nr. 10 391, datë 03.03.2011; Ligjin Nr. 66/2012, datë 07.06.2012; dhe Ligjin Nr. 33/2019 si dhe Udhëzimet e ministrit të Financave, Nr. 29 dhe Nr. 30, datë 28.07.2020.
- h) “Lidhje e ngushtë familjare” bashkëshorti ose ekuivalenti i tij; një prind, fëmijë, motër, vëlla ose një person i tretë i konsideruar si mik nga një palë e tretë e arsyeshme dhe e mirinformuar mbi faktet.
- i) “Tarifë e kushtëzuar”, një pagesë e llogaritur mbi baza të paracaktuara të lidhura me rezultatin/përfundimin e një transaksioni ose rezultatin e punës që do të kryhet.
- j) “Interes financiar i drejtpërdrejtë” është interesi financiar, i cili zotërohet:
 - drejtpërsëdrejti ose është nën kontrollin e një individi ose entiteti të caktuar (përfshirë ato që menaxhohen në mënyrë të tërthortë nga palë të treta) ose
 - tërthorazi nga investimi në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, në fonde investimi ose ndërmjetës të tjerë financiar, mbi të cilat individi ose entiteti ka kontroll.
- k) “Interesi financiar” është pjesëmarrja në kapital apo në asete të tjera financiare, huat ose instrumentet e tjera të borxhit të një entiteti, të cilat kanë si qëllim mundësimin e përfitimit të interesit nga këto forma pjesëmarrjeje financiare.
- l) “Pasqyrat Financiare” përfaqësojnë bilancet, pasqyrat e rezultatit apo llogaritë e humbje-fitimeve, pasqyrat e ndryshimeve në gjendjen financiare (të cilat mund të paraqiten në një

shumëllojshmëri mënyrash, për shembull, si një pasqyrë e flukseve të parasë ose si një pasqyrë e rrjedhjeve të fondeve), shënimet shpjeguese dhe pasqyra e dokumente të tjera shpjeguese, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

- m) “Aktiviteti Profesional” është aktiviteti i ndërmarrë përsipër nga një anëtar në dhënien e shërbimeve të lidhura me fushën e kontabilitetit, këshillimit tatimor, konsulencës në fushën e biznesit dhe financës, por pa u limituar nga sa është parashikuar nga ligji për sferën e aktivitetit të Kontabilistit të Miratuar.
- n) “Shërbime Profesionale” janë shërbimet profesionale që kryhen për llogari të klientit.

Kapitulli i parë. Kërkesa të Përgjithshme të Kodit

Paragrafi 100 Parimet Themelore

Paragrafi 110 Integriteti

Paragrafi 120 Objektiviteti

Paragrafi 130 Kompetenca profesionale dhe vigjilenca e duhur

Paragrafi 140 Mbrojtja e konfidencialitetit

Paragrafi 150 Sjellja profesionale

Paragrafi 100. Parimet Themelore

100.1 Elementi dallues i anëtarit mbajtës të titullit “Kontabilist i Miratuar” është pranimi i përgjegjësisë për të ushtruar veprimtarinë e tij në interes të publikut. Prandaj, përgjegjësia në ushtrimin e profesionit të Kontabilistit të Miratuar nuk është vetëm përbushja e detyrimeve karshi klientit ose punëdhënësit. Në respektimin e interesit publik, Kontabilisti i Miratuar duhet t’i përmbahet Kodit të Etikës si dhe të veprojë në pajtueshmëri me të.

100.2 Ky Kod përmban 2 kapituj. Kapitulli i parë përcakton dhe përkufizon parimet themelore të etikës profesionale për të gjithë anëtarët e Shoqatës si dhe siguron kuadrin konceptual për zbatimin e parimeve themelore. Kuadri konceptual shërben si udhëzues për parimet themelore. Anëtarëve u kërkohet të zbatojnë këtë kuadër konceptual në identifikimin e kërcënimeve ndaj parimeve themelore, të vlerësojnë rëndësinë e tyre, nëse këto kërcënime janë krejtësisht të parëndësishme, të aplikojnë masa mbrojtëse për t’i eliminuar ose zvogëluar kërcënimet në një nivel të pranueshëm, në mënyrë që mos të cenohen parimet themelore.

100.3 Kapitulli i dytë ilustron zbatimin e kuadrit konceptual në situata specifike. Paragrafët e ndryshëm të kapitullit japin shembuj mbi masat mbrojtëse të përshtatshme, që duhet të merren për adresimin e kërcënimeve për të qenë në pajtueshmëri me parimet themelore. Ato gjithashtu përshkruajnë situatat kur marrja e masave mbrojtëse nuk është e mundur në adresimin e kërcënimeve dhe rrjedhimisht rrethana apo marrëdhënia, e cila krijon kërcënim, duhet të shmanget. Kapitulli i dytë u adresohet në veçanti anëtarëve të Shoqatës, kontabilistë të miratuar aktivë dhe shoqërive të kontabilitetit.

100.4 Përdorimi në këtë Kod i fjalës ‘duhet’ vendos detyrimin mbi anëtarin mbajtës të titullit për të përbushur dispozitat, në të cilat shprehja ‘duhet’ është përdorur. Pajtueshmëria është detyrim deri sa përjashtimi të jetë i cilësuar nga ky Kod.

Parimet themelore

100.5 Anëtari duhet t'u përmbahet parimeve themelore sa më poshtë:

- a) **Integriteti** – të jetë i drejtpërdrejtë dhe i ndershëm në të gjitha angazhimet dhe marrëdhëniet e tij profesionale.
- b) **Objektiviteti** - të mos paragjykojë, të ketë konflikt interesi, si dhe të ndikohet në gjykimin e tij profesional nga palë të treta.
- c) **Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur** – të përfitësojë dijet dhe aftësitë e tij profesionale për të siguruar kompetencën e nevojshme në dhënien e shërbimeve në përputhje me praktikat më të mira, legjislacionit si dhe të veprjë në pajtim me standardet profesionale.
- d) **Mbrojtja e konfidencialitetit** – të respektojë konfidencialitetin në trajtimin e informacionit të përfituar si rezultat i veprimtarisë profesionale, përjashtuar rrethanat kur përbën detyrim ligjor dhe profesional. Shpërndarja e informacionit nuk mund të kryhet pa marrë autorizimet përkatëse dhe specifik të nevojshme si dhe është kategorisht e ndaluar shpërndarja e informacionit me qëllim përfitimin personal.
- e) **Sjellja profesionale** – të respektojë detyrimet sa përcaktuar nga ligji, rregulloret e Shoqatës dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si dhe të shmangë çdo veprim që do të diskreditonte profesionin e kontabilistit të miratuar.

Secili nga parimet më sipër cituar do të shtjellohet më në detaj në paragrafët 110-150.

100.6 Kushtet, në të cilat ushtrojnë veprimtarinë anëtarët si dhe natyra e ndryshme e angazhimeve profesionale, mund të krijojnë rreziqe specifike që mund të cenojnë respektimin e parimeve themelore. Në këto kushte është e pamundur të përcaktohet çdo rrethanë, e cila do të krijonte kërcënim për respektimin e parimeve themelore dhe masat e duhura që duhet të ndërmerren. Prandaj, ky Kod siguron një kuadër konceptual për përdoruesit e tij dhe u kërkon atyre të identifikojnë, vlerësojnë si dhe adresojnë kërcënimet në përputhje me sa parashikuar nga parimet themelore. Kuadri konceptual shërben për të mbështetur anëtarët në veprimtarinë e tyre profesionale për të qenë në përputhje me kërkesat etike të këtij Kodi si dhe marrjen e përgjegjësiive për të vepruar në interes të publikut të gjerë. Rrethanat e ndryshme që mund të cenojnë parimet themelore janë të shumëllojshme, prandaj kërkohet gjykimi profesional individual i përdoruesit të këtij kodi, për të përcaktuar nëse një veprim i caktuar është i lejuar ose jo.

100.7 Nëse anëtari identifikon praninë e kërcënimeve, të cilat cenojnë respektimin e parimeve themelore, duhet t'i vlerësojë ato, të përcaktojë nëse është e mundur marrja e masave mbrojtëse të përshtatshme për t'i mënjeluar ose zvogëluar rreziqet. Ky përcaktim kërkon gjykimin profesional të anëtarit si dhe të konsiderojë faktin që nëse një palë e tretë mjaftueshmërisht e informuar mbi kushtet dhe rrethanat, në të cilat ndodhet kontabilisti, do të ishte në gjendje të ndërmerre dhe zbatonte masa mbrojtëse, të cilat do të mënjanonin ose zvogëlonin kërcënimet në një nivel pranueshmërie sa për të mos cenuar respektimin e parimeve themelore.

100.8 Anëtari duhet të vlerësojë çdo kërcënim që do të cenonte respektimin e parimeve themelore kur ku ka dijeni për kërcënimet, ose ka arsye për të besuar që ngjarje ose rrethana të caktuara mund të cenojnë respektimin e parimeve themelore.

100.9 Rëndësia e kërcënimeve kërkon ndërmarrjen e vlerësimeve cilësore dhe sasiore të shkaqeve. Gjatë aplikimit të kuadrit konceptual, anëtari mund të ndeshet me situata, në të cilat kërcënimet nuk mund të mënjahen apo dhe zvogëlohen në një nivel të pranueshëm, pasi ose sepse kërcënimi ka përmasa të mëdha, apo sepse masat mbrojtëse nuk janë të mundura, ose sepse nuk mund të aplikohen. Nëse gjendet përpara këtyre situatave, anëtari duhet të ndërpresë dhënien e shërbimeve, ose kur është e nevojshme të heqë dorë nga angazhimi me klientin (në rastin e Kontabilistit të Miratuar Aktiv) ose të ndërpresë marrëdhënien e punësimit (në rastin e Kontabilistit të Miratuar Pasiv).

100.10 Anëtari në mënyrë të paqëllimshme mund të bjerë ndesh me parashikimet e këtij Kodi. Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së shkeljes, mosrespektimi i parashikimeve të Kodit mund të korrigjohet përmes marrjes së masave të nevojshme dhe të menjëhershme sapo rrethanat që e kanë shkaktuar atë janë zbuluar.

100.11 Kur Kontabilisti i Miratuar ndeshet me situata jonormale, në të cilat aplikimi i parashikimeve specifike të këtij Kodi do të sillte rezultate, të cilat do të cenonin interesin publik, rekomandohet që anëtari të konsultohet me Shoqatën.

Kërcënimet dhe masat mbrojtëse

100.12 Kërcënimet mund të lindin nga një shumëllojshmëri rrethanash dhe marrëdhëniesh. Kur një marrëdhënie apo dhe rrethanë krijon një kërcënim, ky kërcënim mund të cenojë ose mund të konsiderohet si cenus kundrejt parimeve themelore. Një rrethanë ose marrëdhënie mund të krijojë më shumë se një kërcënim dhe një kërcënim i vetëm mund të bjerë ndesh me më shumë se një nga parimet themelore. Kërcënimet kategorizohen në:

- Kërcënimi i përfitimit vetjak – kërcënimi që interesi financiar apo dhe interesa të tjerë të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme gjykimin dhe sjelljen profesionale;
- Kërcënimi nga kryerja e analizave gjithëpërfshirëse– kërcënimi që anëtari të gjejë padrejtësisht shërbimet profesionale të dhëna në të shkuarën nga vetë ai apo dhe nga profesionistë të tretë, të cilët janë njëkohësisht bashkëpunëtorë të ngushtë të tij;
- Kërcënimi i favorizimit – kërcënimi që anëtari të mbivlerësojë gjendjen e klientit apo punëdhënësit në atë pikë sa gjykimi të humbasë objektivitetin;
- Kërcënimi i familjaritetit– kërcënimi që nisur nga marrëdhënia e ngushtë dhe e gjatë me klientin dhe punëdhënësin, anëtari të fitojë simpatinë dhe dashamirësinë apo dhe të shtyhet të pranojë dhënien e shërbimeve të caktuara;
- Kërcënimi i frikësimit – kërcënimi që një anëtar do të zbrapset së vepruari me objektivitet, si pasojë e presionit apo perceptimit të presionit, duke përfshirë edhe tentativën për të ushtruar ndikim të panevojshëm mbi dhënësin e shërbimit profesional.

Kapitulli i dytë i këtij Kodi shpjegon se si kërcënimet mund të lindin respektivisht për Kontabilistët e Miratuar Aktivë dhe Shoqëritë e Kontabilitetit gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre profesional.

100.13 Masat mbrojtëse janë veprime apo dhe masa të tjera që mënjanojnë praninë e kërcënimeve apo dhe i zvogëlojnë ato në një nivel të pranueshëm. Ato klasifikohen në dy kategori kryesore:

- Masa mbrojtëse që burojnë nga ushtrimi i profesionit, ligji apo rregulloret;
- Masa mbrojtëse në mjedisin e punës.

100.14 Masat mbrojtëse të krijuara nga profesioni, ligji apo rregulloret përfshijnë, por nuk limitohen, nga:

- Edukimi, trajnimet dhe eksperiencia e nevojshme për hyrjen në profesion.
- Edukimi i vijueshëm profesional.
- Qeverisja dhe rregulloret korporative. Standardet profesionale.
- Mbikëqyrja e profesionit dhe procedurat disiplinore
- Këqyrja nga palë të treta të autorizuara ligjërisht për sa u përket raporteve, deklaratave tatimore, komunikimeve dhe informacionit të hartuar dhe përpunuar nga Kontabilisti i Miratuar.

100.15 Kapitulli i dytë i këtij Kodi shtjellon masat mbrojtëse në mjedisin e punës për Kontabilistët e Miratuar.

100.16 Disa masa mbrojtëse mund të rrisin gjasat e identifikimit ose parandalimit të sjelljeve joetike. Këto masa mbrojtëse, të cilat mund të burojnë nga profesioni, ligji, rregulloret apo dhe nga punëdhënësi institucional, mund të përfshijnë:

- Sisteme gjurmimi ankesash, të cilat duhet të jenë efektive dhe të mirëreklamuar nga punëdhënësi institucional, profesioni ose mbikëqyrësi i profesionit, të cilat u mundësojnë të gjitha palëve të interesuara të tërheqin vëmendjen mbi qasje joprofesionale dhe joetike të Kontabilistëve të Miratuar
- Detyrimin për të raportuar çdo formë shkeljeje ndaj kërkesave etike.

Zgjidhja e konflikteve etike

100.17 Anëtari mund të ndeshet me konflikt të interesit gjatë ushtrimit të aktivitetit profesional, çka do të krijonte kërcënim ndaj objektivitetit dhe ndaj parimeve të tjera themelore. Këto kërcënimet mund të krijohen kur:

- Anëtari trajton profesionalisht çështje të caktuar biznesi për llogari të dy ose më shumë palëve, interesi i të cilave në lidhje me atë çështje është në konflikt të drejtpërdrejtë; ose
- Interesat e kontabilistit karshi një çështjeje të caktuar, për trajtimin e së cilës është angazhuar profesionalisht edhe karshi një pale të tretë, janë në konflikt ndërmjet tyre.

100.18 Kapitulli i dytë e këtij Kodi trajton konfliktet e interesit për kategorinë e Kontabilistëve të Miratuar Aktivë dhe Shoqëritë e Kontabilitetit.

100.19 Në vlerësimin e përputhshmërisë me parimet themelore, anëtari mund t'i kërkohej të zgjidhë konfliktet në zbatimin e parimeve themelore.

100.20 Kur inicohet procesi i zgjidhjes së konfliktit të interesit, ai mund të jetë zyrtar ose jozyrtar, faktorët e mëposhtëm; qoftë veçmas ose së bashku me faktorë të tjerë, duhet të merren në konsideratë në zgjidhjen e konflikteve të mundshme:

- a) Faktet e rëndësishme;
- b) Problematikat etike të lidhen me faktet;
- c) Parimet themelore të prekura nga çështjet në fjalë;
- d) Procedurat e brendshme;
- e) Alternativat e veprimit.

Mbasi të konsiderohen faktorët kryesorë, anëtari duhet të përcaktojë veprimet e duhura që do të ndërmerren, duke peshuar pasojat për secilën nga zgjedhjet e bëra. Nëse një çështje mbetet e pazgjidhur, kontabilisti i miratuar mund të zgjedhë të kërkojë ndihmë për gjetjen e zgjidhjes nga persona të tretë, të cilët mund të jenë bashkëpunëtorë e tij të ngushtë në angazhimet profesionale.

100.21 Është në interesin më të mirë që anëtari të dokumentojë problematikën, detajet e çdo diskutimi të bërë mbi çështjen në fjalë si dhe vendimet përkatëse të marra.

100.22 Kur një konflikt i rëndësishëm nuk zgjidhet, anëtari mund të shqyrtojë marrjen e këshillimit nga organizata profesionale apo dhe nga këshillues ligjorë, gjithmonë duke paracaktuar kushtin e konfidencialitetit në trajtimin e informacionit. Për shembull, në rastin kur anëtari ka dyshimet që është ndeshur me një mashtrim financiar gjatë punës së tij dhe do t'i duhet të trajtojë informacion konfidencial me palë të treta për të marrë bindjen e arsyeshme mbi dyshimet e ngritura. Në këto kushte, anëtari duhet të konsiderojë edhe kërkesat ligjore nga sa parashikuar nga Ligji për parandalimin e pastrimit të parave për raportimin e fakteve përpara autoriteteve kompetente.

100.23 Nëse një çështje etike mbetet e pazgjidhur edhe pasi janë shqyrtuar të gjitha hapësirat e mundshme për zgjidhjen e tij, anëtari duhet të heqë dorë nga përfshirja në çështjen profesionale që e shkakton konfliktin. Anëtari duhet të jetë në gjendje të përcaktojë nëse veprimi i duhur do të ishte mospërfshirja në çështjen specifike ose heqja dorë nga tërësia e angazhimit profesional me klientin specifik.

Paragrafi 110. Integriteti

110.1 Princi i integritetit sanksionon detyrimin për të gjithë Anëtarët që të jenë të ndershëm dhe të drejtpërdrejtë në angazhimet e tyre, qofshin ato profesionale, ose biznesi. Të sjellurit me integritet nënkupton gjithashtu marrëdhënie të ndershme dhe të sinqerta.

110.2 Anëtari duhet të mos përfshihet në raportime, deklarata, komunikime apo forma të tjera shkëmbimi informacioni, për të cilat ai është i bindur se informacioni në fjalë:

- a) Përmban deklarata të rreme apo që lënë shtigje për keqkuptime;
- b) Përmban deklarata ose informacione të nxituara; ose
- c) Përjashton ose fsheh informacione, anashkalimi i të cilave mund të çorientojë ose mashtrtojë palët e treta të interesuara.

Kur anëtari beson dhe ka prova se informacioni që i është përcjellë dhe vendosur në dispozicion përmbush karakteristikat e mësipërcituara, ky i fundit duhet të ndërmarrë të gjitha hapat për t'u distancuar nga trajtimi i këtij informacioni.

110.3 Nuk do të konsiderohet shkelje e paragrafit të mësipërm rasti kur anëtari do t'u mundësonte palëve të treta të interesuara marrjen e dijenit të çështjeve sa përcaktuar në paragrafin 110.2 përmes publikimit dhe raportimit të fakteve.

Paragrafi 120. Objektiviteti

120.1 Parimi i objektivitetit sanksionon detyrimin e pavarësisë në shprehjen e gjykimit profesional nga ana e anëtarit, i cili mund të ndikohet nga paragjykimet, konflikti i interesave ose ndikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i palëve e treta.

120.2 Anëtari mund të ekspozohet ndaj situatave, të cilat mund të influencojnë parimin e objektivitetit, por mbetet e pamundur për t'i përcaktuar dhe përkufizuar ato. Paragjykimi dhe ndikimi nga palë të treta të gjykimit profesional të kontabilistit duhet ta vendosë këtë të fundit përpara përgjegjësisë mbi ndërprerjen e marrëdhënies profesionale ose shërbimit që ka shkaktuar cenimin e parimit të objektivitetit.

Paragrafi 130. Kompetenca profesionale dhe vigjilenca e duhur

130.1 Parimi i kompetencës profesionale dhe vigjencës së duhur sanksionon mbi anëtarët detyrimet si më poshtë:

- a) Të përditësojnë njohuritë dhe ekspertizën profesionale në masën që do të siguronin shërbime profesionale kompetente;
- b) Të vepruarit me kujdes dhe në përputhje me standardet teknike dhe profesionale.

130.2 Dhënia e shërbimeve profesionale kompetente kërkon ushtrimin e gjykimit të shëndoshë në zbatimin e njohurive dhe aftësive profesionale gjatë angazhimeve profesionale. Kompetenca profesionale mund të ndahet në dy faza të veçanta:

- a) Arritja e kompetencës profesionale; dhe
- b) Mbajtja e kompetencës profesionale.

130.3 Mbajtja e kompetencës profesionale kërkon ndërgjegjësimin e vazhdueshëm dhe asimilimin e përditësimeve teknike dhe profesionale të përshtatshme, si dhe zhvillimet në botën e biznesit. Edukimi i vijueshëm profesional, i cili kërkon pjesëmarrjen e detyrueshme vjetore të anëtarëve, u

mundëson këtyre të fundit, të zhvillojnë dhe të përditësojnë njohuritë e nevojshme në të vepruarit me kompetencë dhe në përputhje me praktikën e profesionit.

130.4 Kujdesi përfshin përgjegjësinë për të vepruar në përputhje me specifikat e angazhimeve profesionale, vëmendje si dhe respektimin e afateve kohore.

130.5 Anëtari duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshme që sigurojnë garancitë e nevojshme, se personat të cilët punojnë nën autoritetin e tij kanë njohuritë dhe trajnimet e duhura profesionale.

130.6 Kur gjykohet e nevojshme, anëtari duhet të ndërgjegjësojë klientët, vartësit e tij, palë të treta të interesuara mbi kufizimet e qenësishme në dhënien e shërbimeve.

Paragrafi 140. Mbrojtja e konfidencialitetit

Në terma të përgjithshme, përbën detyrim ligjor ruajtja e konfidencialitetit mbi informacionin, i cili është përvetësuar nga rrethana që sanksionojnë ruajtjen e sekretit profesional. Ekzistojnë disa rrethana, në të cilat ligji parashikon thyerjen e këtij detyrimi. Paragrafët e mëposhtëm ndihmojnë për të kuptuar në praktikë trajtimin e konfidencialitetit si dhe udhëzojnë anëtarët mbi standardet e kërkuara për një qasje sa më etike.

140.1 Parimi i konfidencialitetit detyron të gjithë anëtarët të shmangin:

- a) Shpërndarjen jashtë ambientit të punës së tyre të informacioneve konfidenciale, të përfituara si rrjedhojë e angazhimeve profesionale ose marrëdhënies së punës pa marrë paraprakisht autorizimet ndaj palëve të treta të përfshira. Përrjashtim do të përbënin vetëm rastet kur ekziston e drejta ose detyrimi ligjor apo edhe profesional për ta shpërndarë si informacion;
- b) Përdorimin e informacioneve konfidenciale të përfituara si rrjedhojë e angazhimeve profesionale apo marrëdhënies së punës për përfitime personale apo edhe përfitime të të tretëve.

140.2 Anëtari duhet t'i përmbahet parimit të konfidencialitetit në trajtimin e të dhënave, përfshirë mjediset sociale të cilat ai frekuenton, si dhe të jetë vigjilent ndaj mundësisë së shpërndarjes së informacionit në mënyrë të paqëllimshme, veçanërisht kundrejt partnerëve të ngushtë në biznes apo dhe ndonjë pjesëtar të familjes, qoftë ky i fundit shumë i afërt.

140.3 Anëtari duhet ti përmbahet parimit të konfidencialitetit në trajtimin e informacionit të përcjellë nga një klient apo dhe punëdhënësi i mundshëm.

140.4 Anëtari duhet t'i përmbahet parimit të konfidencialitetit në trajtimin e informacionit si brenda ambienteve ku ushtron profesionin e tij, apo edhe në ambientet ku është i punësuar.

140.5 Anëtari duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme dhe të sigurohet që personeli, me të cilin bashkëpunon, respektojnë detyrimin në trajtimin konfidencial të informacionit.

140.6 Nevoja për t'iu përmbajtur principit të konfidencialitetit vazhdon dhe pas përfundimit të marrëdhënies me klientin apo edhe punëdhënësin. Kur anëtari ndryshon punëdhënësin apo vendos një marrëdhënie biznesi nga e para me një klient të ri, ai rezervon të drejtën të shfrytëzojë eksperiencën profesionale të përfituar deri në atë moment, por nuk duhet ta përdorë apo shpërndajë informacionin që ka karakter konfidencial, të çfarëdo natyre qoftë ai, i cili është i përfituar si rezultat i marrëdhënieve të mëparshme profesionale.

140.7 Parimi themelor i konfidencialitetit i shërben interesit publik, pasi ndihmon në vënien në dispozicion të informacionit nga klienti tek anëtari. Gjithsesi, anëtari mund të gjendet në kushte ku t'i kërkohet të ndajë informacion me karakter konfidencial dhe dhënia e këtij informacioni është e përshtatshme kur:

- a) Shpërndarja lejohet me ligj dhe autorizimet përkatëse janë marrë nga pala e interesuar, si për shembull:
 - i. Riprodhimi i dokumentacionit apo dhe evidencave të tjera gjatë proceseve gjyqësore;
 - ii. Vënia në dispozicion ndaj autoriteteve ligjzbatuese të fakteve në kundërshtim me ligjin, për të cilat anëtari ka marrë dijëni gjatë ushtrimit të profesionit;
 - iii. Vënia në dispozicion e informacionit ndaj autoriteteve kompetente në rastet e dyshimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- b) Në rastet kur dhënia e informacionit përbën detyrim ose të drejtë profesionale dhe pavarësisht se ligji nuk e ndalon shpërndarjen e tij:
 - i. Për t'iu përgjigjur thirrjes së nisjes së një procesi investigimi nga organizata profesionale apo dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
 - ii. Për të mbrojtur interesin profesional të një anëtari në proceset gjyqësore; ose
 - iii. Për të respektuar standardet profesionale dhe kërkesat etike.

140.8 Për të përcaktuar nëse informacioni konfidencial duhet shpërndarë ose jo, faktorë të rëndësishëm duhen të merren në konsideratë:

- a) Nëse interesi i të gjitha palëve, përfshirë ato palë, interesi i të cilave mund të ndikohet ose dëmtohet, nëse dhënësi i pëlqimit jep autorizimin për shpërndarjen e informacionit.
- b) Nëse i gjithë informacioni me karakter të rëndësishëm është i njohur dhe i bazuar në fakte, deri në atë masë që është e mundur; kur faktet janë të pabazuara, informacionet apo konkluzionet jo të plota, kërkohet gjykimi profesional për të përcaktuar deri në ç'masë duhet shpërndarë informacioni.
- c) Llojin e komunikimit që pretendohet dhe kujt i adresohet.
- d) Bindjen që të gjitha palët, ndaj të cilave adresohet informacioni, janë marrësit e duhur të tij.

Paragrafi 150. Sjellja profesionale

150.1 Parimi i sjelljes profesionale vendos detyrimin mbi të gjithë anëtarët për të respektuar ligjin dhe rregulloret përkatëse si dhe të shmangin çdo veprim, që kanë marrë dijëni ose hamendësohet që duhet të jenë në dijëni, të cilat mund të diskreditojnë profesionin. Përfshihen veprimet për të

cilat një palë e tretë e informuar dhe e arsyeshme, mbasi vihet në kushtet e anëtarit, do t'i gjykonte si cenime të emrit të mirë që gëzon profesioni.

Anëtari, i cili shfaq sjellje negative ndaj emrit të mirë që gëzon Shoqata, përbën element për nisjen e procedurave të investigimit nga Komisioni i Disiplinor i Shoqatës.

150.2 Shembull i respektimit të këtij parimi është marketingu dhe promovimi i punës së anëtarit, i cili duhet të tregohet i ndershëm dhe i sinqertë dhe jo:

- a) Të mbivlerësojë shërbimet që ofron, kualifikimet profesionale ose eksperiencën që ka fituar në kohë; ose
- b) Të bëjë deklarata ose referime të rreme dhe krahasime të paqena për punën e të tretëve.

Kapitulli i dytë. Kontabilistët e miratuar dhe shoqëritë e kontabilitetit

Paragrafi 200 Hyrje

Paragrafi 210 Emërimi profesional

Paragrafi 220 Konfliktet e interesit

Paragrafi 230 Opinionet dytësore

Paragrafi 240 Tarifat dhe shpërblimet

Paragrafi 250 Marketimi i shërbimeve profesionale

Paragrafi 260 Dhuratat dhe trajtimet preferenciale

Paragrafi 270 Marrja në ruajtje e aseteve të klientit

Paragrafi 280 Objektiviteti – Të gjitha shërbimet

Paragrafi 290 Pavarësia

Paragrafi 200. Hyrje

200.1 Ky kapitull i Kodit ilustron mënyrën e zbatimit të kuadrit konceptual në praktikë nga Kontabilistët e Miratuar Aktivë dhe Shoqëritë e Kontabilitetit, pavarësisht faktit se mbetet e pamundur të specifikohen të gjitha rrethanat dhe marrëdhëniet, të cilat krijojnë ose mund të krijojnë kërcënime ndaj parimeve themelore. Gjithsesi, Kontabilisti i Miratuar dhe Shoqëria e Kontabilitetit nxiten të jenë të kujdesshme ndaj rrethanave dhe marrëdhënieve, të cilat paraqesin këto veçanti.

200.2 Kontabilisti i miratuar dhe shoqëria e kontabilitetit duhet të mos angazhohen profesionalisht në marrëdhënie, për të cilat kanë dijeni që mund të cenojnë integritetin, objektivitetin dhe reputacionin e mirë që gëzon profesioni dhe si rrjedhojë të jenë në kundërshtim me parimet themelore.

Kërcënimet dhe masat mbrojtëse

200.3 Pajtueshmëria mes parimeve themelore mund të cenohet nga një mori rrethanash dhe marrëdhëniesh. Rëndësia dhe natyra e kërcënimeve mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së marrëdhënies profesionale, si dhe llojit të shërbimit që kërkohet nga klienti.

200.4 Shembuj të rrethanave, të cilat mund të krijojnë kërcënime për kontabilistin e miratuar/shoqërinë e kontabilitetit, të cilat burojnë nga interesi personal përfshijnë, por nuk limitohen:

- Interesi financiar në një klient ose interesi financiar i përbashkët me klientin;
- Varësia e tepruar nga tarifat e përfituara nga një klient specifik;
- Marrëdhënie e ngushtë e biznesit me klientin;
- Shqetësimi që mund të burojë nga humbja e mundshme e një klienti të rëndësishëm.
- Marrëdhënie huaje me klientin ose drejtuesit e tij;
- Marrja dijeni e pasaktësive me rëndësi të madhe në pasqyrimin e të dhënave ekonomiko-financiare të viteve të mëparshme, të cilat janë përgatitur nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Kontabilistit të Miratuar.

200.5 Shembuj të rrethanave, të cilat mund të krijojnë kërcënime për kontabilistin e miratuar/shoqërinë e kontabilitetit, të cilat burojnë nga analizat gjithëpërfshirëse përfshijnë, por nuk limitohen, në sa më poshtë:

- Zbulimin e pasaktësive me rëndësi gjatë angazhimit për kryerjen e analizave gjithëpërfshirëse për llogari të klientit;
- Përfshirjen në raportimin e sistemeve informatike financiare të klientit mbasi është përfshirë personalisht në zgjedhjen dhe implementimin e këtyre sistemeve;

- Është angazhuar personalisht në përgatitjen e të dhënave fillestare që kanë shërbyer për gjenerimin e të dhënave, të cilat janë subjekt analize.

200.6 Shembuj të rrethanave, të cilat mund të krijojnë kërcënime dhe që kanë trajtën e përkrahjes, përfshijnë, por pa u limituar, në sa më poshtë:

- Kontabilisti i miratuar/shoqëria e kontabilitetit joshet nga premtimi i klientit në partneritet/ortakëri në biznes gjatë hartimit të pasqyrave financiare të këtij të fundit.

200.7 Shembuj të rrethanave, të cilat mund të krijojnë kërcënime dhe që kanë trajtën e familjaritetit, përfshijnë, por nuk limitohen në:

- Stafi, i cili punon drejtpërsëdrejti nën autoritetin dhe për llogari të kontabilistit të miratuar/shoqërisë së kontabilitetit, ka lidhje të ngushta familjare me stafin drejtues të klientit;
- Stafi, i cili punon drejtpërsëdrejti nën autoritetin dhe për llogari të kontabilistit të miratuar/shoqërisë së kontabilitetit, ka lidhje të ngushta familjare me punonjësit e klientit, të cilët mund ushtrojnë ndikim mbi rezultatin e angazhimit profesional;
- Ish-ortaku i shoqërisë së kontabilitetit mbulon pozicione drejtuese ose mbulon pozicione pune për llogari të klientit dhe që mund të ushtrojnë ndikim të fortë mbi rezultatin e punës;
- Pranimi i dhuratave ose marrja e trajtimeve të privileguara nga kontabilisti i miratuar aktiv/shoqëria e kontabilitetit, përjashtuar këtu rastet kur vlera e tyre është e parëndësishme.

200.8 Shembuj të rrethanave, të cilat mund të krijojnë kërcënime dhe kanë trajtën e frikësimit përfshijnë, por pa u limituar, në sa më poshtë:

- Kërcënimi për ndërprerjen e marrëdhënies profesionale nga ana e klientit;
- Kontabilisti i miratuar/shoqëria e kontabilitetit kërcënohet me padi gjyqësore;
- Kërcënimi për zvogëlimin e volumit të punës së nevojshme për t'u kryer me qëllim reduktimin e tarifës së shërbimit;
- Kontabilisti i miratuar/shoqëria e kontabilitetit ndihet nën trysni për të dakordësuar me gjykimin e punonjësve të klientit mbi çështje specifike pasi këta të fundit mund të kenë njohuri dhe ekspertizë më të madhe për çështjet në fjalë.

200.9 Kontabilisti i miratuar/shoqëria e kontabilitetit mund të konstatojnë se një rrethanë specifike mund të krijojë kërcënime unike ndaj përputhshmërisë me parimet themelore. Pa dyshim, këto kërcënime unike nuk mund të kategorizohen. Kontabilisti i miratuar duhet gjithmonë të jetë i vëmendshëm ndaj rrethanave dhe kërcënimeve të tilla.

200.10 Shembuj të masave mbrojtëse të krijuara nga profesioni, ligji dhe rregulloret janë të parashikuara në paragrafët 100.12-100.16 të kapitullit të parë të këtij Kodi.

200.11 Në mjedisin e punës, masat mbrojtëse të rëndësishme varen nga kushtet dhe rrethanat. Masat mbrojtëse të mjedisit të punës mund të jenë të përgjithshme dhe të parashikuara nga hartimi

i rregulloreve të brendshme nga kontabilisti i miratuar/shoqëria e kontabilitetit ose mund të hartohen posaçërisht ndaj një angazhimi me një klient specifik. Në të dyja rastet, kontabilisti i miratuar/shoqëria e kontabilitetit duhet të përcaktojnë mënyrën më të mirë të trajtimit të kërcënimeve të mundshme që mund të lindin.

200.12 Shembuj nga tërësia e masave mbrojtëse të implementuara në mjedisin e punës nga hartimi i rregulloreve të përgjithshme mund të përfshijnë:

- Zhvillimi i një kulture drejtuese në mjedisin e punës, e cila vendos theksin mbi rëndësinë që ka zbatimi i parimeve themelore;
- Politikat dhe procedurat në implementimin dhe monitorimin e kontrollit të cilësisë së angazhimeve profesionale;
- Hartimi i manualeve dhe procedurave të brendshme të dokumentuara, të cilat shërbejnë për të identifikuar, vlerësuar rëndësinë, kërcënimet dhe nevojën e marrjes së masave mbrojtëse për të qenë në përputhje me parimet themelore;
- Procedura dhe politika, të cilat do të mundësonin identifikimin e konfliktit të interesit ndërmjet kontabilistit të miratuar dhe klientit;
- Politika dhe procedura për të ndaluar ndikimin e palëve të treta mbi rezultatin e angazhimit profesional;
- Komunikimi në kohë i procedurave dhe politikave ndaj stafit të kontabilistit të miratuar, përfshirë ndryshimet në to, si dhe trajnimi dhe edukimi i duhur mbi këto procedura dhe politika.
- Caktimi i një punonjësi të lartë për të qenë përgjegjës mbi monitorimin e sistemit të kontrollit të cilësisë.
- Përcaktimi dhe vendosja e një mekanizmi disiplinor që do të shërbente për të nxitur zbatueshmërinë e politikave dhe procedurave.
- Publikimi i procedurave dhe politikave do të shërbente për të nxitur stafin e kontabilistit të miratuar të komunikojnë me nivelet më të larta drejtuese në lidhje me çështje që do të kërcënonin respektimin e parimeve themelore.

200.13 Shembuj nga tërësia e masave mbrojtëse, të cilat kufizohen nga specifikat e angazhimeve profesionale përfshijnë:

- Përfshirja e një punonjësi të dytë për të rishikuar punën e kryer;
- Konsultimin dhe marrjen e opinionit nga një palë e tretë e pavarur, që mund të jetë profesionist i fushës, organizatë profesionale apo dhe autoriteti mbikëqyrës i profesionit;
- Ngritja dhe diskutimi i çështjeve të etikës me personat përgjegjës për qeverisjen e klientit;
- Përfshirjen e një kontabilisti të miratuar të dytë për të vijuar ose rikontrolluar pjesërisht punën e kryer;

200.14 Në varësi të natyrës së angazhimit, kontabilisti i miratuar në ushtrimin e profesionit mund të mirëbesojë dhe bazohet në masat mbrojtëse që vetë klienti ka vënë në zbatim. Gjithsesi, masat mbrojtëse të klientit mbeten të pamjaftueshme për reduktimin e kërcënimeve në një nivel të pranueshëm.

Paragrafi 210. Emërimi i Kontabilistit të Miratuar/Shoqërisë së Kontabilitetit**Pranimi i klientit dhe vijimësia e angazhimit profesional**

210.1 Përpara se të pranojë një marrëdhënie me një klient të ri, kontabilisti i miratuar/shoqëria e kontabilitetit, duhet të vlerësojë nëse pranimi mund të krijojë ndonjë kërcënim që bie ndesh me parimet themelore. Kërcënimet e mundshme ndaj integritetit apo sjelljes profesionale mund të lindin si rrjedhojë, për shembull, çështje që lidhen me klientin (ortakërinë, drejtimin ose aktivitetin ekonomik që ai ushtron), për të cilat nëse merret dijeni mund të kërcënojnë pajtueshmërinë me parimet themelore.

Shembuj të kërcënimeve të tilla përfshijnë:

- Përfshirjen e klientit në aktivitete të jashtëligjshme (si për shembull, pastrimi i parave);
- Pandershmëria;
- Dyshime mbi mënyrën e raportimit financiar;
- Sjellje të tjera joetike.

210.2 Kontabilisti i miratuar duhet të vlerësojë secilin kërcënim të mundshëm nga pikëpamja e rëndësisë që paraqesin dhe masat mbrojtëse përkatëse duhet të zbatohen për eliminimin ose zvogëlimin e tyre në një nivel të pranueshëm.

Shembuj të masave mbrojtëse përfshijnë:

- Marrjen dijeni dhe njohjen e mirë të klientit, ortakëve, drejtuesve të klientit, si dhe të atyre të veshur me përgjegjësinë e qeverisjes së veprimtarisë së aktivitetit të klientit;
- Sigurimin e angazhimit të klientit mbi adresimin e duhur të çështjeve që kanë nevojë për vëmendje, për shembull, përmirësimi i praktikave të qeverisjes dhe përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Siguron që çdo problematikë është adresuar dhe pranuar në letrën e pranimit të angazhimit

210.3 Paralelisht me vlerësimin e kërcënimeve ndaj zbatueshmërisë së parimeve themelore, kontabilisti i miratuar duhet të vlerësojë dhe ndjekë kërcënimin që shërbimet që po i jepen klientit po shërbejnë për të lehtësuar procesin e pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit. Ky vlerësim duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe udhëzimet përkatëse. Ligji për parandalimin e pastrimit të parave zbatohet kur: anëtari i Shoqatës angazhohet profesionalisht me një klient, për të cilin është i sigurt mbi vazhdimësinë e angazhimit në kohë; anëtari kryen për llogari të klientit transaksione financiare me vlerë jo më pak se 1,000,000 Lekë (një milion) ose kundërvlera në valutë të huaj; ose ekziston dyshimi që klienti është i përfshirë në aktivitete të lidhura me pastrimin e parave.

210.4 Kërkesat ligjore mbi kontabilistin e miratuar për të siguruar përputhshmërinë ndaj udhëzimeve për parandalimin e pastrimit të parave, mund të gjenden edhe në Rregulloren e SH.K.F.SH.-së për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Dështimi në respektimin e këtyre kërkesave do të përbënte cenim të pajtueshmërisë me parimin themelor të sjelljes profesionale.

210.5 Kur vërehet pamundësia e zvogëlimit të kërcënimeve në nivele të pranueshme, kontabilisti i miratuar duhet të zgjedhë të mos pranojë ose edhe të heqë dorë nga angazhimi profesional me klientin.

210.6 Kërcënime të mundshme ndaj parimeve themelore mund të burojnë dhe mbas pranimin të klientit, për të cilat nëse kontabilisti i miratuar do të kishte pasur dijeni në fazën përpara nënshkrimit të angazhimit, do të përbënin arsye konkrete për mospranimin e klientit. Për këtë arsye, kontabilisti i miratuar duhet të rishikojë vazhdimisht marrëdhëniet kontraktuale me klientët, të cilat përsëriten në kohë, për të vlerësuar praninë e kërcënimeve të mundshme. Për shembull, kërcënimi ndaj parimeve themelore mund të krijohet nga një sjellje joetike të një klienti të caktuar, e tillë si administrimi jokorrekt i të ardhurave të shoqërisë ose vlerësime jokorrekte të aktiveve/pasive të bilancit. Nëse kontabilisti i miratuar identifikon një kërcënim ndaj parimeve themelore, anëtari duhet të vlerësojë rëndësinë e këtij kërcënimi dhe të zbatojë masa mbrojtëse kur gjykohet e arsyeshme për t'i eliminuar ose zvogëluar kërcënimin në një nivel të pranueshëm. Kur nuk është e mundur eliminimi ose zvogëlimi i kërcënimit në nivel të pranueshëm, kontabilisti i miratuar duhet të vlerësojë ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve profesionale me klientin.

Pranimi i angazhimit profesional

210.7 Parimi themelor i kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur sanksionon detyrimin mbi kontabilistin e miratuar të pranojë vetëm ato shërbime profesionale, për të cilat zotëron kompetencën profesionale për t'i kryer. Përpara se t'i nënshtrohet angazhimit me një klient, Kontabilisti i Miratuar duhet të përcaktojë nëse pranimi krijon ndonjë kërcënim për zbatueshmërinë e parimeve themelore. Për shembull, kërcënim i cili buron nga interesi personal dhe që ndikon mbi kompetencën profesionale dhe vigjilencën e duhur mund të krijohet kur kontabilisti i miratuar nuk zotëron, ose nuk mund të përvetësojë, kompetencat e nevojshme për të kryer me sukses dhënieve të shërbimeve, për të cilat është kontraktuar.

210.8 Kontabilisti i miratuar duhet të vlerësojë rëndësinë e kërcënimeve dhe të marrë masa, kur është e nevojshme për t'i eliminuar ato ose reduktuar në një nivel të pranueshëm.

Shembuj të masave mbrojtëse përfshijnë:

- Sigurinë se zotëron njohjen e duhur të natyrës së veprimtarisë ekonomike që ushtron klienti, kompleksitetin e operacioneve, specifikat e kërkesave të angazhimit dhe qëllimin, natyrën dhe objektin e punës që duhet të kryhet;
- Sigurinë se zotëron njohjen e duhur mbi industrinë ku vepron klienti dhe mbi çështjet që do trajtohen gjatë angazhimit;
- Zotërimi ose eksperiencia e duhur ndaj kërkesave të ligjit për raportimin financiar;
- Alokimi i burimeve njerëzore me eksperiencën e duhur;
- Konsultimi i ekspertëve të jashtëm kur kjo nevojitet;
- Dakordësimi me klientin dhe respektimi i afateve kohore në angazhimet profesionale;

- Pajtueshmëria me politikat e monitorimit të cilësisë dhe procedurat e nevojshme të vëna në jetë, të cilat mundësojnë sigurinë e arsyeshme që angazhimi specifik do të pranohet vetëm kur ai mund të shërbehet me kompetencë.

210.9 Kontabilisti i miratuar mund të mbështetet mbi këshillimin ose punën e një eksperti të jashtëm, për të cilën ai duhet të mund të sigurohet mjaftueshëmrisht mbi cilësinë e punës së këtij të fundit. Faktorë, të cilët duhet të konsiderohen paraprakisht, përfshijnë: reputacionin, ekspertizën, aplikueshmërinë e standardeve etike dhe profesionale të ekspertit të jashtëm, informacione të cilat mund të sigurohen nga bashkëpunime të mëparshme ose nga marrja e referencave.

Ndryshimet në emërimin profesional

210.10 Nëse kontabilistit të miratuar i kërkohet të zëvendësojë kontabilistin e miratuar të mëparshëm, ose nëse po shqyrton mundësinë për të tenderuar për t'u angazhuar me një klient, i cili shërbehet nga një kontabilist i miratuar tjetër, duhet të përcaktojë nëse ka ndonjë arsye, profesionale ose jo, për të mos pranuar angazhimin, rrethana të tilla, të cilat do të krijojnë kërcënime të tilla për të cenuar pajtimin me parimet themelore, të cilat nuk do të mund të eliminohen ose reduktohen në nivele të pranueshme. Për shembull, mund të krijojë kërcënim kundrejt kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur mosmarrja dijani paraprakisht e të gjitha fakteve përpara pranimin të angazhimit me klientin.

210.11 Kontabilisti i miratuar duhet të vlerësojë rëndësinë e secilit kërcënim. Masat mbrojtëse duhet të zbatohen kur është e nevojshme për të eliminuar ose zvogëluar çdo kërcënim në një nivel të pranueshëm.

210.12 Të tilla masa mbrojtëse përfshijnë:

- Kur i përgjigjeni kërkesës për tenderim, shprehni në ofertën tuaj, përpara pranimin të angazhimit, kërkesën të kontaktoni me kontabilistin e miratuar/shoqërinë e kontabilitetit të mëparshme, në mënyrë të tillë për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë arsye profesionale ose tjetër arsye, për të cilën angazhimi nuk do të mund të pranohet;
- Pyetjen dhe marrjen e informacionit nga kontabilisti i miratuar/shoqëria e kontabilitetit të mëparshme mbi faktet apo informacionet që disponon, për të cilat ky i fundit i gjykon se janë të rëndësishme t'u vihen në dispozicion përpara se të vendosni mbi pranimin e angazhimit;
- Marrjen e informacioneve të nevojshme nga burime të tjera.

210.13 Kur kontabilisti i miratuar i propozuar ndodhet në pamundësi për të komunikuar me kontabilistin e miratuar të mëparshëm, ai duhet të përpiqet të marrë informacion nga burime të tjera mbi mundësinë e kërcënimeve, si për shembull nga intervistimi i palëve të treta ose referenca mbi karakterin dhe integritetin e stafit drejtues dhe të atyre të veshur me përgjegjësinë e qeverisjes së aktivitetit të klientit.

210.14 Kontabilistit të miratuar mund t'i kërkohej të marrë përsipër punë, të cilat mund të jenë plotësuese ose shtesë e kontabilistit të miratuar të mëparshëm. Në këtë rrethanë mund të krijohet kërcënim mbi kompetencën profesionale dhe të dilijencës së duhur, e cila buron, si për shembull, nga hendeku i informacionit jo të plotë. Rëndësia e çfarëdo kërcënimi duhet të vlerësohet dhe masat mbrojtëse të ndërmerren kur gjykohej e nevojshme për të eliminuar ose minimizuar kërcënimet në nivel të pranueshëm. Shembull i masave mbrojtëse të tilla mund të jetë njoftimi i kontabilistit të miratuar të mëparshëm mbi punën e propozuar, e cila do t'i mundësonte këtij të fundit në përcjelljen e të gjithë informacionit të nevojshëm për të vijuar rregullisht në angazhimin profesional me klientin.

210.15 Kontabilistit të miratuar në përgjithësi do t'i duhet të marrë autorizimin e klientit, e preferueshme në formë të shkruar për të filluar diskutimin me kontabilistin e miratuar aktiv të mëparshëm. Njëherë që autorizimi është dhënë, kontabilisti i miratuar aktiv/shoqëria e kontabilitetit e mëparshme duhet t'u përmbahet kërkesave ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie. Kur kontabilisti i miratuar aktiv/shoqëria e kontabilitetit e mëparshme ndan informacionin, informacioni duhet të jetë i vërtetë dhe të mos krijojë keqkuptime. Nëse kontabilisti i miratuar aktiv/shoqëria e kontabilitetit e propozuar nuk e ka të mundur diskutimin me kontabilistin e miratuar aktiv/shoqërinë e kontabilitetit të mëparshme, i propozuari duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar nga burime të treta, përfshirë marrjen në pyetje të drejtuesve të lartë të klientit, përgjegjës për qeverisjen mundësinë e lindjes së kërcënimeve.

210.16 Kontabilisti i miratuar i mëparshëm dhe ai në detyrë janë të detyruar ndaj trajtimit konfidencial të informacionit. Nëse kontabilisti i miratuar i mëparshëm është lejuar ose do t'i kërkohej të ndajë informacionin me kontabilistin e miratuar të propozuar, kjo do të varet nga natyra e angazhimit dhe nëse:

- Është marrë autorizimi nga klienti për të kërkuar informacion;
- Kërkesat ligjore dhe etike të lidhura me këto komunikime dhe ndarje informacioni mund të ndryshojnë në varësi të legjislacionit.

Në përcaktimin nëse informacione të caktuara duhet t'i komunikohen kontabilistit të miratuar të propozuar në detyrë, kontabilisti i miratuar i mëparshëm, nëse ka dijeni ose ka dyshime se klienti është i përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, duhet të jetë i vetëdijshëm mbi përgjegjësitë që bien mbi të nga parashikimet ligjore në ligjin e Parandalimit të pastrimit të parave, në veçanti për sa i përket pengimit të hetimeve.

Paragrafi 220. Konflikti i interesit

220.1 Kontabilisti i miratuar mund të ndeshet me situata që krijojnë konflikte interesi gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Konflikti i interesit mund të krijojë kërcënim ndaj të qenit objektiv, si dhe ndaj parimeve të tjera themelore. Të tilla kërcënim mund të krijohen kur:

- Kontabilisti i miratuar jep shërbime profesionale për çështje të caktuara kundrejt dy ose më shumë klientëve, interesi i të cilëve ndaj shërbimeve në fjalë mund të jetë në konflikt; ose

- Interesi i kontabilistit të miratuar dhe një klienti, ndaj të cilit ka marrë një angazhim profesional, në trajtimin e një çështjeje të caktuar, është në konflikt.

Kontabilisti i miratuar nuk duhet të lejojë që konflikti i interesit të cenojë gjykimin e tyre profesional.

220.2 Shembuj të rrethanave, të cilat mund të krijojnë konflikte interesi, janë:

- Këshillimin njëkohësisht të dy klientëve, të cilët janë konkurrentë në blerjen e së njëjtës kompani dhe ku këshillimi mund të jetë i rëndësishëm në përcaktimin e palës fituese;
- Dhënien e këshillimit kundrejt dy palëve të interesuara ndaj të njëjtit transaksion;
- Përgatitjen e raporteve të vlerësimit të aseteve për dy palë që kanë interesa të kundërta me njëra-tjetrën karshi asetit;
- Përfaqësimin e dy klientëve në lidhje me trajtimin e së njëjtës çështje, për të cilën palët kanë ngritur një padi gjyqësore kundrejt njëra-tjetrës, të tilla si ndarja e pasurisë gjatë zgjidhjes martesore ose shpërbërjes së një partneriteti;
- Këshillimin e një klienti për të investuar në një biznes, për shembull, bashkëshortja e kontabilistit të miratuar ka interes financiar;
- Dhënien e këshillimit ndaj një klienti, ndërkohë që gëzon pjesëmarrje ose interes të ngjashëm me konkurrentin kryesor të klientit;
- Këshillimin e klientit mbi blerjen e një biznesi specifik, për të cilën kontabilisti i miratuar është po aq e interesuar në blerjen e tij;
- Këshillimin e klientit në blerjen e një produkti/shërbimi, për të cilën kontabilisti i miratuar luan rolin e komisionerit për palën shitëse;

220.3 Kur identifikon dhe vlerëson marrëdhënien, që mund të krijojë konflikt të interesit, për të cilën duhet të ndërmerren masa mbrojtëse, aty kur është e nevojshme, për t'i eliminuar ose zvogëluar kërcënimet në një nivel të pranueshëm për të qenë në pajtim me parimet themelore, kontabilisti i miratuar duhet të gjykojë profesionalisht dhe të marrë në konsideratë nëse një palë e arsyeshme dhe e mirinformuar, e ndodhur në të njëjtat pozita të kontabilistit, do të gjykonte se parimet themelore nuk janë cenuar.

220.4 Në adresimin e konflikteve të interesit, përfshirë ato për dhënien e informacionit konfidencial ndaj stafit të kontabilistit të miratuar ose palëve të treta për marrjen e udhëzimeve, anëtari duhet të jetë i vetëdijshëm mbi parimin themelor të konfidencialitetit.

220.5 Nëse kërcënimi i krijuar nga konflikti i interesit nuk është në një nivel të pranueshëm, kontabilisti i miratuar duhet të zbatojë masat mbrojtëse për t'i eliminuar ose zvogëluar kërcënimet në një nivel të pranueshëm. Nëse masat mbrojtëse nuk e zvogëlojnë kërcënimin në një nivel të pranueshëm, kontabilisti i miratuar duhet të refuzojë vazhdimësinë ose marrjen përsipër të angazhimit profesional kundrejt klientit; ose duhet të ndërpresë marrëdhëniet ose lidhjet e interesit, të cilat nuk mundësojnë reduktimin e konfliktit në nivel të pranueshëm.

220.6 Përpara se kontabilisti i miratuar të vendosë të pranojë një klient të ri, ose të ndërmarrë përsipër angazhime profesionale, duhet të ndërmerren të gjitha hapat për të identifikuar rrethanat, të cilat mund të krijojnë kërcënime, përfshirë identifikimin e:

- Natyrës së interesit ose marrëdhënies ndërmjet të gjitha palëve të përfshira; dhe
- Natyrës së shërbimit dhe implikimet që mund të kenë mbi palët.

Natyra e shërbimeve, interesit dhe marrëdhënieve mund të hasin ndryshime gjatë periudhës së angazhimit profesional. Ky mund të jetë rasti kur kontabilistit të miratuar përfshihet në një angazhim profesional ku rrethanat mund të shfaqin kërcënime në të ardhmen, edhe pse në momentin e nënshkrimit të marrëdhënies kontraktuale palët nuk janë të përfshira në mosmarrëveshje. Kontabilisti i miratuar duhet të jetë në gatishmëri dhe i vetëdijshëm mbi ndryshimet e mundshme me qëllim identifikimin e kushteve që do të provokonin lindjen e konflikteve të interesit.

220.7 Me qëllim identifikimin e interesave dhe marrëdhënieve, të cilat mund të krijojnë konflikte të interesit, ngritja e një procedure të brendshme nga ana e kontabilistit të miratuar do të ndihmonte procesin e identifikimit të konflikteve të mundshme përpara se të ndërmerren hapa për pranimin e angazhimit profesional ose dhe në vazhdimësi të marrëdhënies kontraktuale me klientin. Identifikimi i konflikteve të interesit në faza të hershme do të rriste mundësinë e marrjes së masave mbrojtëse, të cilat do të eliminonin kërcënimin ndaj objektivitetit si dhe ndaj parimeve të tjera themelore në nivel të pranueshëm. Procesi i identifikimit të konflikteve aktuale ose potenciale të interesit do të varet nga faktorë si:

- Natyra e shërbimeve profesionale që do ofrohen;
- Ngarkesa e angazhimeve profesionale të ndryshme;
- Përmasat dhe natyra e veprimtarive të klientëve që shërbehen;
- Struktura e punës së kontabilistit të miratuar, si numri i stafit të punësuar apo edhe prezenca gjeografike në rrethe të ndryshme.

220.8 Nëse kontabilisti i miratuar është pjesë e një rrjeti të profesionistëve së fushës, procesi i identifikimit të konflikteve të interesit do të shtrihej edhe mbi konfliktet e mundshme të anëtarëve të rrjetit profesionale. Hapa të arsyeshëm për identifikimin e interesave, marrëdhënieve konfliktuale që do të përfshinin rrjetin profesional, do të vareshin nga faktorë si: natyra e shërbimeve profesionale që ofrohen, tipologjia e klientëve që shërbehen nga rrjeti si dhe nga prezenca gjeografike e palëve të interesuara.

220.9 Nëse një konflikt i interesit do të identifikohet, kontabilisti i miratuar do duhet të vlerësonte:

- Rëndësinë e interesave ose marrëdhënieve; dhe
- Rëndësinë e kërcënimeve, të cilat shkaktohen nga ushtrimi i profesionit dhe dhënia e shërbimeve. Në përgjithësi, sa më e afërt lidhja ndërmjet shërbimit profesional dhe çështjes për të cilën palët janë në konflikt interesi, aq më i rëndësishëm është kërcënimin ndaj objektivitetit dhe zbatimit të parimeve të tjera themelore.

220.10 Kontabilisti i miratuar duhet të zbatojë masa mbrojtëse, aty ku e shikon të nevojshme, për të eliminuar kërcënimet që burojnë nga konflikti i interesit në mënyrë që parimet themelore të mos cenohen. Shembuj të masave mbrojtëse të tilla përfshijnë:

- Vënia në zbatim e mekanizmave për të parandaluar shpërndarjen e paautorizuar të informacioneve konfidenciale në dhënien e shërbimeve profesionale kundrejt dy ose më shumë palëve, interesi i të cilave mbi çështjen specifike është në konflikt. Kjo situatë mund të përfshijë:
 - Kontabilisti i miratuar ndan dhe angazhon grupe pune të ndara, të cilave u vihen në dispozicion politika dhe procedura të qarta mbi trajtimin e sekretit profesional në trajtimin e informacionit;
 - Aksesimin e kufizuar fizik dhe elektronik të informacioneve, vetëm për sa i takon rolit që secili nga stafi i grupeve të punës ka në angazhimin me klientin;
 - Vendosjen e politikave dhe procedurave në kufizimin e aksesimit të dosjeve të klientëve;
 - Nënshkrimin e deklaratave për ruajtjen e sekretit profesional nga personeli.
- Rishikimi i vazhdueshëm i aplikueshmërisë së masave mbrojtëse nga stafi drejtues, jo i përfshirë drejtpërsëdrejti në angazhimin me klientin
- Konsultimin me palë të treta, si për shembull, organizata profesionale, këshillues ligjor ose një profesionit i tretë kontabël.

Paragrafi 230. Përgjegjja ndaj mosrespektimit të ligjit

Qëllimi

230.1 Një anëtar mund të ndeshet me rrethana ose të marrë dijeni mbi mospajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret gjatë angazhimit profesional me një klient specifik. Qëllimi i këtij paragrafi është për të përcaktuar përgjegjësitë e anëtarit kur ndeshet ose ka dyshime me të tilla mospajtueshmëri dhe të udhëzojë anëtarin në vlerësimin e implikimeve masat që duhet të ndërmerren. Ky paragraf zbatohet, pavarësisht natyrës së klientit, nëse është njësi me interes publik ose jo.

230.2 Mosrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve përfshin veprimet e kryerjes ose shmangies, me vullnet ose pa vullnet, nga klienti, ose nga stafi i klientit, qoftë ai në pozicione drejtuese, të cilat janë në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

230.3 Kur anëtari ndeshet ose dyshon për mospajtueshmëri me ligje dhe rregullore, ai ka përgjegjësinë t'u përmbahet parashikimeve ligjore, përfshirë dhe raportimin e fakteve pranë autoriteteve kompetente.

230.4 Elementi dallues i profesionit të kontabilistit të miratuar është pranimi i përgjegjësisë për të vepruar për llogari të interesit publik. Në përgjigjen ndaj faktimit ose dyshimeve të cënueshmërisë së ligjit dhe rregulloreve, objektivat e anëtarit janë:

- T'u përmbahet parimeve themelore të integritetit dhe sjelljes profesionale;
- njoftimin e stafit drejtues të klientit, për të kërkuar:
 - marrjen e masave mbi pasojat e mosrespektimit të ligjit dhe rregulloreve
 - parandalojnë veprimet e jashtëligjshme kur ato ende nuk janë kryer.
- të ndërmarrin hapa të tjerë të nevojshëm.

Fushëveprimi

230.5 Ky paragraf përcakton qasjen që duhet të ketë anëtari, i cili ndeshet ose ka dyshime mbi mosrespektimin e:

- ligjeve dhe rregulloreve, të cilat sanksionojnë dhe rregullojnë profesionin dhe raportimin e pasqyrave financiare; dhe
- ligjeve dhe rregulloreve, të cilat, pavarësisht se nuk i përkasin sferës së profesionit të kontabilistit të miratuar, por që zbatimi i tyre është i rëndësishëm për veprimtarinë e klientit, vazhdimësinë e veprimtarisë së tij, ose në mënjanimin e gjobitjeve për kundërvajtje.

230.6 Disa shembuj të ligjeve dhe rregulloreve, të cilat kanë interes për t'u trajtuar në këtë paragraf janë:

- mashtrimi, korrupsioni aktiv dhe pasiv;
- pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe të ardhurat nga aktivitete kriminale;
- shërbimet dhe produktet financiare dhe bankare;
- mbrojtja e të dhënave;
- detyrimet dhe pagesat ndaj autoriteteve tatimore;
- mbrojtja e ambientit;
- shëndeti publik dhe siguria në punë.

230.7 Mosrespektimi i ligjeve dhe udhëzimeve mund të çojë në gjobitjen, paditjen dhe pasoja të tjera për klientin, të cilat mund të kenë pasoja materiale mbi pasqyrat financiare. Pasojat më të rënda nga mosrespektimi i ligjeve dhe udhëzimeve mund të bien mbi interesin publik, si dëmtimi i investitorëve, kreditorëve, punonjësve apo dhe publikut të gjerë. Për qëllime të këtij paragrafi, një veprim i cili mund të shkaktojë pasoja të rënda mbi secilën nga kategoritë e sipërpërmendura mund të ketë natyrë financiare ose jofinanciare. Shembujt e ndryshëm përfshijnë rastet kur mashtrimi ka pasoja mbi investitorët me pasojat e humbjeve të mëdha financiare, mosrespektimi i ligjeve për mbrojtjen e ambientit mund të dëmtojë seriozisht shëndetin e punonjësve ose komunitetit.

Vlerësimi i rrethanave dhe kushteve kur një çështje e caktuar duhet denoncuar pranë autoriteteve kompetente.

230.8 Denoncimi i rasteve pranë autoriteteve kompetente mund të përjashtohet vetëm kur ligji ose udhëzimet e ndryshme nuk e parashikojnë. Në të kundërt, denoncimi do të kishte qëllimin e vetëm që autoritetet kompetente të hetonin mbi çështjen si dhe zbatimi i masave të ndërmerrej për mbrojtjen e interesit publik.

230.9 Përcaktimi nëse një çështje e caktuar duhet denoncuar do të varej nga natyra dhe përmasat e dëmit ndaj investitorëve, kreditorëve, punonjësve ose interesit publik. Për shembull, kontabilisti i miratuar mund të vlerësojë se denoncimi i çështjes pranë autoriteteve kompetente është veprim i duhur nëse:

- njësia ekonomike është e përfshirë në korrupsion (për shembull kundrejt një zyrtari vendas ose të huaj për përfitimin e një kontrate pune të rëndësishme);
- aktiviteti i ushtruar nga njësia ekonomike është i licencuar dhe çështja në fjalë do të cenonte licencën për të ushtruar veprimtarinë;
- produktet e cilësuar si të dëmshme për sigurinë dhe shëndetin publik ka të ngjarë të tregtohen nga njësia ekonomike;
- klienti po ndihmon klientët e tij me skema tatimore për shmangien e detyrimeve ndaj autoriteteve tatimore.

Vlerësimi nëse një çështje duhet denoncuar varet edhe nga faktorë të jashtëm, si për shembull:

- nëse ekziston autoriteti përkatës ku informacioni mbi çështjen në fjalë mund të përcillet, çka do të shkaktonte nisjen e hetimeve dhe marrjen e masave. Autoriteti përkatës do të varej nga natyra e çështjes, për shembull, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në rastin e mosrespektimit të ligjeve përkatëse ose Banka e Shqipërisë në rastin e një mashtrimi në raportimin financiar nga një bankë e nivelit të dytë;
- nëse ekziston një kuadër ligjor, i cili të siguron mbrojtjen e duhur ndaj një hakmarrjeje të mundshme kriminale si rrjedhojë e denoncimit të fakteve;
- nëse ekzistojnë kërcënime ndaj sigurisë fizike të anëtarit ose personave të tjerë.

230.10 Nëse anëtari vendos të denoncojë mosrespektimin e ligjeve, ky fakt nuk do të përbënte shkak për mosrespektimin e parimit themelor të konfidencialitetit. Në denoncimin e fakteve, anëtari duhet të veprojë në mirëbesim si dhe të tregohet i sinqertë dhe i drejtë në deklarin e ngjarjeve. Anëtari mund të vlerësojë edhe rrethanat nëse duhet informuar paraprakisht klienti mbi denoncimin e fakteve.

Shërbime të tjera profesionale, përjashtuar shërbimin e auditimit të pasqyrave financiare

Marrjen dijani, informimi mbi çështjen dhe adresimi i saj ndaj stafit përgjegjës me qeverisjen

230.11 Nëse një anëtar i angazhuar në dhënien e shërbimeve profesionale të ndryshme nga auditimi i pasqyrave financiare dhe merr dijani për çështje që nuk janë në përputhje me ligjin, ai duhet të kuptojë dhe vlerësojë çështjen në fjalë, përfshirë natyrën dhe rrethanat që e kanë shkaktuar.

230.12 Anëtarit i kërkohet të shfrytëzojë njohuritë, gjykimin profesional dhe ekspertizën, por nuk kërkohet që ai të ketë njohuri të thelluara mbi ligjin dhe rregullat përtej sa parashikohet nga natyra e shërbimit profesional, për të cilën ai ka marrë angazhim. Në vlerësimin nëse një çështje është e ligjshme ose jo, i takon gjykatës dhe autoriteteve kompetente. Në varësi të natyrës së çështjes, kontabilisti i miratuar mund të kërkojë asistencë të jashtme, gjithmonë në respekt të parimit të konfidencialitetit.

Paragrafi 240. Tarifat dhe format e tjera të shpërblimit

240.1 Kur negociohen shërbimet profesionale, kontabilisti i miratuar duhet të mund të kërkojë tarifën që ai e vlerëson të arsyeshme. Fakti që një kontabilist i miratuar aplikon një tarifë më të ulët se një profesionist i tjetër i fushës, në vetvete nuk përbën një qasje joetike. Megjithatë, mund të shfaqen kërcënime të respektimit të parimeve themelore, të cilat mund të lindin si rrjedhojë e nivelit të tarifës së aplikuar. Për shembull, një kërcënim i përfitimit personal ndaj kompetencës profesionale dhe vigjilencës së duhur mund të burojë si pasojë e faktit që tarifa e aplikuar mund të jetë aq e ulët sa do të ishte e pamundur të vihen në zbatim teknikat dhe ekspertiza profesionale e duhur me specifikat që kërkon angazhimi profesional.

240.2 Prania dhe rëndësia e këtyre kërcënimeve të mundshme do të varet nga faktorë si shuma e tarifës së aplikuar dhe shërbimit, të cilit i referohet ajo. Rëndësia e secilit kërcënim duhet të vlerësohet dhe masat mbrojtëse të aplikohen kur vlerësohet e nevojshme për të eliminuar ose minimizuar kërcënimet në nivele të pranueshme. Shembuj të masave mbrojtëse të tilla janë:

- Vënia në dijeni e klientit mbi kushtet e angazhimit dhe në veçanti bazat e vlerësimit të përdorura në përcaktimin e tarifës dhe cilat shërbime përfshihen në tarifë; ose
- Alokimin e kohës së nevojshme dhe stafit të kualifikuar për trajtimin e çështjeve objekt angazhimi profesional.

240.3 Tarifat e kushtëzuara përdoren gjerësisht, të cilat gjithsesi mund të krijojnë kërcënime ndaj pajtueshmërisë me principet themelore në rrethana specifike. Ato mund të krijojnë kërcënim ndaj objektivitetit si rrjedhojë e interesit personal. Ekzistenca dhe rëndësia e kërcënimeve të tilla do të varet nga faktorë përfshirë:

- Natyrën e angazhimit;
- Gamën e tarifave të mundshme;
- Bazën për përcaktimin e tarifës;
- Nëse rezultati i punës do të rishikohet nga një palë e tretë e pavarur.

240.4 Kontabilisti i miratuar duhet të vlerësojë rëndësinë e secilit prej këtyre kërcënimeve dhe të marrë masat mbrojtëse kur e vlerëson të nevojshme për të eliminuar ose zvogëluar kërcënimet në nivele të pranueshme. Shembuj të masave mbrojtëse të tilla përfshijnë:

- Marrëveshje kontraktuale paraprake me klientin mbi bazën e tarifimit që do të aplikohet;
- Ndarja e informacionit me palët e interesit të përfshira në angazhimin profesional si dhe bazën e përdorur për tarifimin;
- Procedurat dhe politikat e monitorimit të cilësisë; ose
- Rishikimi nga një palë e tretë e pavarur e punës së kryer nga kontabilisti i miratuar.

Komisionet

240.5 Në rrethana specifike, kontabilisti i miratuar mund të përfitojnë një komision ose tarifë për referimin e klientit. Për shembull, nëse kontabilisti i miratuar nuk ofron shërbimin specifik të

kërkuar nga klienti, një tarifë mund të përfitohet nga referimi i klientit drejt një kontabilisti të miratuar tjetër ose eksperti të fushës, për të cilën shërbimi kërkohet. Kontabilisti i miratuar mund të përfitojë një komision nga një palë e tretë (për shembull, tregtuesi i një aplikacioni informatik) në lidhje me shitjen e të mirave dhe shërbimeve kundrejt klientit. Pranimi i komisionit ose e tarifës së referencës mund të krijojë një kërcënim mbi objektivitetin dhe emërimin profesional që buron nga interesi personal i këtij të fundit.

240.6 Kontabilisti i miratuar mund të paguajë një tarifë për referimin e një klienti, për shembull, kur klienti vazhdon të jetë i angazhuar profesionalisht me një kontabilist të miratuar tjetër, por kërkon shërbime profesionale shtesë, të cilat nuk mund të mundësohen nga ky i fundit. Pagesa e kësaj tarife për referimin mund të krijojë një kërcënim për objektivitetin, kompetencën profesionale dhe vigjilencën e duhur si rrjedhojë e interesit personal.

240.7 Rëndësia e kërcënimit duhet të vlerësohet dhe masat mbrojtëse duhet të aplikohen kur janë të nevojshme për të eliminuar ose minimizuar kërcënimin në një nivel të pranueshëm. Shembuj të masave mbrojtëse të tilla janë:

- Vënia në dijeni e klientit mbi ekzistencën e një marrëveshje për të paguar një tarifë për referimin e tij kundrejt një kontabilisti të miratuar, i cili ka referuar për klientin;
- Vënia në dijeni e klientit mbi ekzistencën e një marrëveshje për të pranuar një tarifë për referimin e tij kundrejt një tjetër kontabilisti të miratuar; ose
- Nënshkrimin e një marrëveshjeje paraprake me klientin për përfitimin e komisioneve nga shitja e të mirave dhe shërbimeve nga një palë e tretë kundrejt klientit.

Paragrafi 250. Marketingu i shërbimeve profesionale

250.1 Kur kontabilisti i miratuar reklamon shërbimet profesionale përmes reklamave apo dhe formave të tjera të marketingut, mund të lindin kërcënime për pajtueshmërinë me principet themelore.

250.2 Kontabilisti i miratuar, kur marketon shërbimet profesionale, duhet të jetë i kujdesshëm të mos ndërmarrë veprime që do të diskreditonin profesionin. Kontabilisti i miratuar duhet të jetë i ndershëm dhe i besueshëm, dhe jo:

- a) Të bëjë premtime të parealizueshme për shërbimet që do të ofrojë, kualifikimet që zotëron, ose eksperiencën e përfituar; ose
- b) Të bëjë deklarata përçmuese ose krahasime të pabazuara kundrejt punës së të tretëve.

Nëse kontabilisti i miratuar gjendet përpara dilemës nëse forma e marketimit është e duhura, ai duhet t'i drejtohet për konsultim organizatës profesionale, në të cilën bën pjesë.

Paragrafi 260. Dhuratat dhe trajtimet preferenciale

260.1 Kontabilistit të miratuar, ose një pjesëtari të familjes së tij, mund t'i ofrohen dhurata ose trajtime preferenciale nga një klient. Këto rrethana mund të krijojnë kërcënime ndaj principeve

themelore. Për shembull, interesi personal ose familjar mund të kërcënojë objektivitetin nëse një dhuratë pranohet nga klienti; frika e të bërit publik të faktit të pranimit të ofertave të klientit mund të frikësojë dhe si rrjedhojë cenojë objektivitetin e punës së kontabilistit të miratuar.

260.2 Prania dhe rëndësia e secilit kërcënim do të varet nga natyra, vlera dhe qëllimi që mbart dhurata/trajtimi preferencial i klientit. Kur dhuratat ose trajtimet preferenciale ofrohen kundrejt një pale të tretë të arsyeshme dhe të mirinformuar, duke konsideruar të gjitha kushtet dhe rrethanat, do të konsiderohet e parëndësishme, kontabilisti i miratuar mund të arrijë në përfundimin se dhurata/trajtimi preferencial është bërë në kushte normale të të bërit biznes dhe nuk ka për qëllim të ndikojë gjykimin profesional ose të përfitojë informacion nga kontabilisti i miratuar aktiv. Në këto kushte, kontabilisti i miratuar mund të dalë në përfundimin që çdo formë kërcënimi me pajtueshmërinë me principet themelore është në nivele të pranueshme.

260.3 Kontabilisti i miratuar duhet të vlerësojë rëndësinë e secilit kërcënim dhe të ndërmarrë masa mbrojtëse kur është e nevojshme për të eliminuar ose minimizuar kërcënimet në një nivel të pranueshëm. Kur kërcënimet nuk mund të eliminohen ose minimizohen në një nivel të pranueshëm nga marrja e masave mbrojtëse, kontabilisti i miratuar duhet të mos pranojë ofertën e bërë nga klienti.

Paragrafi 270. Kujdestaria ndaj asetëve të klientit

270.1 Kontabilisti i miratuar aktiv duhet të mos marrë kujdestarinë e mjeteve monetare të klientit ose asetëve të tjera nëse nuk lejohet nga ligji dhe në përputhje me parashikimet ligjore për kujdestarinë e asetëve.

270.2 Kujdestaria e asetëve të klientit krijon kërcënime me parimet themelore; për shembull, ekziston kërcënimi që buron nga interesi personal mbi qasjen profesionale dhe kërcënimi që mund të cenojë objektivitetin si rrjedhojë e kujdestarisë. Kontabilistit të miratuar që i janë besuar mjetet monetare (ose asete të tjera), të cilat janë në pronësi të tretëve, duhet gjithsesi:

- a) T'i mbajë këto asete veçmas nga ato personale ose të klientit;
- b) T'i përdorë këto asete vetëm për qëllimin e duhur;
- c) Të jetë i gatshëm në çdo moment të japë llogari për asetet, të ardhurat, dividendët, fitimet kapitale të gjeneruara, cilitdo personi që i lind e drejta për të kërkuar llogari; dhe
- d) Pajtohet me të gjitha rregulloret, ligjet specifike që rregullojnë kujdestarinë dhe dhënien llogari të këtyre asetëve.

270.3 Procedurat e pranimit për shërbimet që përfshijnë marrjen në kujdestari të asetëve të klientit, kontabilisti i miratuar duhet të marrë dijeni të plotë mbi burimin e asetëve si dhe të shqyrtojë legjislacionin dhe rregulloret në fuqi. Për shembull, nëse aseti ka si burim aktivitete jo të ligjshme, si për shembull pastrimi i parave, mund të krijohet kërcënim ndaj principeve themelore. I gjendur në këto rrethana, kontabilisti i miratuar mund të kërkojë këshillimin ligjor.

Paragrafi 280. Objektiviteti mbi të gjitha shërbimet

280.1 Kontabilisti i miratuar në dhënien e shërbimeve profesionale duhet të konsiderojë nëse ekzistojnë kërcënime ndaj principit themelor të objektivitetit, që mund të burojnë nga pasja e një interesi në dhënien e shërbimeve, ose marrëdhënia me klientin ose drejtuesit dhe punonjësit e njësisë ekonomike. Për shembull, kërcënimi i objektivitetit mund të burojë nga pasja e një marrëdhënieje personale, familjare ose biznesi.

280.2 Ekzistenca e kërcënimeve ndaj objektivitetit kur ofrohen shërbime profesionale do të varet nga rrethanat specifike të angazhimit profesional dhe natyra e punës që do të kërkohet.

280.3 Kontabilisti i miratuar duhet të vlerësojë rëndësinë e secilit kërcënim dhe të ndërmarrë masa mbrojtëse kur janë të nevojshme për të eliminuar ose minimizuar në një nivel të pranueshëm kërcënimet.

Shembuj të këtyre masave mbrojtëse përfshijnë:

- Heqja dorë nga grupi i punës;
- Procedura mbikëqyrjeje;
- Përfundimin e marrëdhënies nga e cila burojnë kërcënimet;
- Diskutimi i çështjes me nivelet e larta drejtuese;
- Diskutimi i çështjes me drejtuesit e klientit.

Nëse masat mbrojtëse nuk mund të eliminojnë ose minimizojnë kërcënimin në një nivel të pranueshëm, kontabilisti i miratuar duhet të zgjedhë të heqë dorë ose ndërpresë marrëdhënien me klientin.